



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- A1 Ministria nuk ka prezantuar në mënyrë të saktë llogaritë e arkëtueshme nga lejet ujore në PVF, duke i nënvlerësuar ato për 28,861€.
- A2 Ministria nuk ka paraqitur një detyrim në vlerë prej 270,000€ në PVF si detyrim i papaguar, duke rezultuar në raportim jo të plotë të detyrimeve.
- B1 MMPHI ka realizuar pagesa në vlerë prej 469,885€ për 61 punonjës, për të cilët nuk ka evidenca për vijueshmëri në punë.
- B2 Janë identifikuar mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, të cilat në total kanë ndikuar në mbivlerësim të pasurive kapitale për 40,172,324€. Po ashtu, në dy raste nuk është siguruar dokumentacioni mbështetës, duke kufizuar procedurat e auditimit për verifikimin e saktësisë së regjistrimeve.
- B3 Detyrimet kontingjente të prezantuara në PFV ishin mbivlerësuar për efektin neto prej 7,141€, ndërsa për një padi prej 180,000€ nuk janë siguruar dëshmitë përkatëse.
- B4 Shpenzimet ishin keq klasifikuar në vlerë prej 2,735,190€, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive jo adekuate.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A3 Në shtatë raste janë identifikuar që projektet rrugore ishin kontraktuar pa leje ndërtimore, duke reflektuar mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore dhe kontrolleve të brendshme.
- A4 Në tri procedura të prokurimit, kishte mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave.
- A5 Në pesë raste janë evidentuar mosrespektime të afateve ligjore në trajtimin e aplikimeve për pëlqime dhe leje mjedisore.
- A6 Në një rast, është përdorur kontratë kornizë me çmime të poentuara, por njëkohësisht është përfshirë edhe pragu  $\pm 30\%$ , në kundërshtim me rregulloren e prokurimit publik.
- A7 Në katër pagesa me vlerë të përgjithshme prej 2,021,300€ kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh.
- B5 Ministria nuk ka respektuar plotësisht dispozitat e Rregullores nr. 001/2022 për kontratat me çmime për njësi. Si pasojë, janë evidentuar tejkalime të sasive në vlerë totale prej 1,281,497€, si dhe mosrealizime të sasive të planifikuara në vlerë prej 688,243€.
- C1 Në dy kontrata ishin bërë ndryshime të sasive të kontraktuara duke rritur/zvogëluar sasinë e realizuar pa aprovime paraprake dhe si rezultat tejkalimet e sasive ishin deri në 38 pozicione apo në vlerë deri në 235,815€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Çështje tjera**

- 1 Ministria gjatë vitit 2025 ka funksionuar si një entitet i vetëm, me buxhet të përbashkët, ndërsa nga viti 2026 është ndarë në dy institucione të veçanta: Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me buxhete përkatëse të ndara. Për këtë arsye, rekomandimet e këtij raporti u adresohen të dyja ministrive, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.
- 2 Pagesat të cilat ishin informata të klasifikuara nuk janë mbuluar me procedurat audituese për shkak të natyrës së tyre të klasifikuar dhe si rrjedhojë, nuk janë pjesë e këtij raporti.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, janë identifikuar çështje që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më tepër fokus janë çështjet me ndikim në opinionin financiar, të cilat lidhen kryesisht me paraqitje jo të saktë dhe jo të plotë të pasqyrave financiare. Këto përfshijnë mosprezantimin e obligimeve të papaguara, nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe dobësitë në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, duke ndikuar në paraqitjen e gjendjes reale të pasurive dhe detyrimeve. Sa i përket fushës së shpenzimeve, edhe këtë vit janë evidentuar raste të klasifikimit jo adekuat të shpenzimeve, si dhe kompensimi i të punësuarve në mungesë të evidencave të mjaftueshme për vijueshmëri në punë.

Sa i përket pajtueshmërisë me Legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet dobësive në menaxhimin e prokurimit dhe projekteve kapitale, përfshirë procesin e vlerësimit të ofertave, moskërkimin e sqarimeve për ofertat me çmime jo normalisht të ulëta, si dhe aplikimin jo të drejtë të peshimit të çmimeve dhe pragut  $\pm 30\%$  në kontrata.

Po ashtu, vëmendje kërkojnë mungesa e lejeve ndërtimore për projekte rrugore, dobësitë në zbatimin e projekteve kapitale, si dhe mangësitë në përdorimin e platformës elektronike të e-prokurimit. Në fushën e të hyrave dhe mjedisit, problematike mbetet mosvazhdimi i lejeve ujore dhe mangësitë në përlogaritjen dhe arkëtimin e obligimeve financiare, si dhe vonesat dhe mosrespektimi i afateve ligjore në trajtimin e aplikimeve për leje dhe pëlqime mjedisore.

Gjithashtu, janë evidentuar çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, përfshirë mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore dhe dhënien e shtesave për vëllim të punës pa përmbushje të kriterëve ligjore.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, në kontekst të pagesave, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet pagesave përmes vendimeve gjyqësore të cilat në vazhdimësi po i shkaktojnë ministrisë kosto shtesë për kamatë dhe shpenzime gjyqësore dhe vonesave në pagesën e faturave.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të sigurojnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, përfshirë shpalosjet në shënimet shpjeguese, si dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme në raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore në menaxhimin e fondeve publike.

Ky raport ka rezultuar me 26 rekomandime, nga të cilat 10 janë rekomandime të përsëritura, tri rekomandime janë pjesërisht të zbatuara dhe 13 janë rekomandime të reja. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja A1 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme të lejeve ujore në PVF**

- Gjetja** Bazuar në Rregulloren Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16 përcakton se “Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”.
- Ministria ka prezantuar në mënyrë jo të saktë llogaritë e arkëtueshme nga lejet ujore në pasqyrat financiare vjetore, duke i nënvlerësuar ato për 28,861€. Nga gjashtë vendimet financiare të lëshuara për një operator, vlera e obligimeve ndaj Ministrisë është 553,247€, ndërsa në PFV është prezantuar 524,386€, çka paraqet nënvlerësim në këtë shumë.
- Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së harmonizimit të rregullt ndërmjet vendimeve financiare të lëshuara, si dhe për shkak të mungesës së evidencave të plota për pagesat dhe kontrolleve të pamjaftueshme në këtë proces.
- Ndikimi** Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes financiare dhe rrit rrezikun që të hyrat të mos menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë adekuate.
- Rekomandimi A1** Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të siguroj mbajtjen e evidencave të plota dhe të azhurnuara për pagesat dhe obligimet e operatorëve, si dhe të forcojë kontrollet e brendshme në këtë proces, në mënyrë që të sigurohet evidentim i saktë dhe i plotë i llogarive të arkëtueshme dhe prezantim i saktë i tyre në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A2 - Mos prezantim i obligimit të papaguar në PVF**

- Gjetja** Sipas Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 17, pika 3 kërkon që organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.
- Me rastin e pagesës së një padie në vlerë prej 309,734€ (urdhër transferi ndaj Thesarit me datë 02.10.2025), është ekzekutuar pagesa në vlerë prej 39,734.25€ në muajin dhjetor 2025, ndërsa pjesa e mbetur prej 270,000€ nuk është paraqitur në PVF si detyrim i papaguar.
- Megjithëse ZKF kishte kërkuar nga Thesari informatat lidhur me vendimet gjyqësore që ishin në pritje për ekzekutim, me qëllim të paraqitjes së saktë të obligimeve të papaguara në PVF, për shkak të ekzekutimit të gabuar të pagesës nga ana e Thesarit, obligimi nuk ishte reflektuar saktë në PVF. Çështja u identifikua gjatë auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës.
- Ndikimi** Mosparaqitja e detyrimit të mbetur në PVF rezulton në shpalosje jo të plotë të detyrimeve, duke kufizuar transparencën dhe informimin e plotë për obligimet ekzistuese.

**Rekomandimi A2** Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të siguroj që të gjitha detyrimet e krijuara deri në fund të vitit raportues, pavarësisht nivelit të ekzekutimit të pagesave, të identifikohen dhe të shpalosen në mënyrë të plotë në PVF. Po ashtu, duhet të siguroj që pagesat e ekzekutuara nga Thesari të krahasohen me dokumentacionin mbështetës pas realizimit të tyre.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë dhe angazhim të punonjësve**

**Gjetja** Neni 17.2 i Rregullores së re (QRK) Nr.04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë zyrtarëve publik, përcakton se "Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale." Tutje, neni 17.3 përcakton se "Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues".

Punonjësit e angazhuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit nuk janë të sistemuar në pozita të rregullta dhe, sipas të dhënave të disponueshme, nuk ushtrojnë aktivitet në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Në total, janë 61 punonjës në këtë kategori.

Gjatë vitit 2025, për këta punonjës janë realizuar pagesa në vlerë prej 469,885€. Megjithatë, nuk janë ofruar dëshmi për vijueshmërinë në punë apo për angazhimin e tyre. Kjo çështje është evidentuar edhe në vitet e kaluara, por nuk janë ndërmarrë masa për ta zgjidhur.

Kjo çështje paraqet sfidë për Ministrinë në sistemimin e këtyre punonjësve në pozita dhe hapësira të përcaktuara pune, për shkak të mungesës së objektivave të qarta të punës, si rrjedhojë e së cilës ata nuk janë të angazhuar në aktivitete konkrete në kuadër të Ministrisë.

**Ndikimi** Pagesat e realizuara në mungesë të evidencave për vijueshmëri dhe angazhim në punë janë shpenzime të paarsyetuara dhe ndikojnë negativisht në transparencë dhe llogaridhënie.

**Rekomandimi B1** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të analizojnë situatën e krijuar dhe të ndërmarrin veprime konkrete për zgjidhjen e saj, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe duke lidhur pagesat me angazhimin real në punë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive****Gjetja**

Neni 10 i Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se "Të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit". Neni 11.3 përcakton se "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Tutje, neni 6.3 i kësaj rregulloreje përcakton: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në regjistrat kontabël në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Në memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë dhe Komunave përkatëse, theksohet se pas pranimit teknik të punimeve të kryera nga operatori ekonomik, investimi (projekti) kalon në pronësi të komunës. Ky investim më pas regjistrohet si pronë e komunës, si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SIMFK).

Janë identifikuar mangësi në regjistrimin e pasurive, të cilat kanë ndikuar që regjistri i pasurive kapitale të mbivlerësohet për 41,150,054€, ndërsa i njëjti të nënvlerësohet për 977,730€.

Mangësitë kryesore përfshijnë:

- Në gjashtë raste, projektet e bashkëfinancuara me komunat, edhe pse të përfunduara dhe të pranuar teknikisht, nuk janë larguar nga regjistri i investimeve në vijim. Vlera e financuar nga Ministria është 4,183,662€. Po ashtu, një pasuri e regjistruar në përdorim me vlerë neto prej 27,692€ duhet të largohet nga regjistri, pasi është regjistruar gabimisht si pasuri në përdorim, ndërsa në fakt përfaqëson bashkëfinancim me Komunën e Obiliqit dhe i takon kësaj komune).

- Projekti për zgjerimin e pistës dhe sistemet përkatëse në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës është regjistruar si pasuri e MMPHI-së në vlerë prej 33,566,305€, edhe pse nuk është në pronësi të saj. Si rezultat, regjistri është mbivlerësuar për 29,538,349€ (pas zhvlerësimit). Po ashtu, pagesat për inxhinierin e pavarur në vlerë prej 1,093,437€ janë regjistruar gabimisht si investime në vijim. Kjo çështje është përsëritur ndër vite pa ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

- Në pesë projekte, pasuritë në vlerë totale prej 2,629,395€ vazhdojnë të mbahen si investime në vijim, edhe pse projektet kishin përfunduar dhe ishin pranuar teknikisht. Si rrjedhojë, nuk ishte bërë transferimi i tyre në pasuri në përdorim dhe nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Katër prej këtyre projekteve janë infrastrukurore, ndërsa një i takon Agjencisë Kadastrale. Në dy raste, në vlerë prej 312,124€, zhvlerësimi nuk është aplikuar për shkak të mungesës së evidencës së plotë të pagesave në SIMFK, ndërsa në një projekt tjetër, zhvlerësimi ende nuk është reflektuar. Vetëm në dy raste kemi mundur të kalkulojmë zhvlerësimin, ku është evidentuar mbivlerësim i pasurisë në vlerë neto prej 749,486€. Gjithashtu, në një prej këtyre projekteve është evidentuar gabim në regjistrim, ku një faturë

individuale për projektin është regjistruar si pasuri në përdorim, ndërkohë që pjesa tjetër e pagesave për të njëjtin projekt ishte regjistruar si investim në vijim.

- Dy pasuri në vlerë prej 497,794€, që lidhen me sinjalizimin rrugor dhe nuk plotësojnë kriteret për pasuri kapitale, janë regjistruar si investime në vijim, duke mbivlerësuar regjistrin për këtë vlerë.

- Në 11 raste, pagesat për shpronësim dhe kompensime të realizuara përmes vendimeve gjyqësore përfshijnë kamatë ligjore në vlerë prej 3,012,184€, e cila është përfshirë në vlerën e pasurisë, si rezultat regjistri i pasurisë është mbivlerësuar për të njëjtën shumë.

- Mosregjistrimi i pasurisë mbi 1,000€ në SIMFK - Në një rast, pagesa në vlerë prej 847,542€ për rehabilitimin e rrugës N25.3 Killokot-Gjilan nuk ishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK. Si rezultat, pasuritë mbi 1,000€ ishin nënvlerësuar për të njëjtën vlerë.

- Mosregjistrimi i pasurisë nën 1,000€ në sistemin e-Pasuria - Një pagesë në vlerë prej 40,460€ për pajisje të teknologjisë informative nuk ishte regjistruar në sistemin e-Pasuria gjatë vitit 2025. Po ashtu, katër fatura për pajisje nën 1,000€ nga vitet paraprake, në vlerë totale prej 89,728€, gjithashtu nuk ishin regjistruar. Si rezultat, regjistri i pasurisë nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për gjithsej 130,188€.

- Nuk janë siguruar dy lëndë për qëllime të auditimit: njëra që ka të bëjë me rindërtimin dhe ndriçimin publik, në vlerë prej 152,024€, e regjistruar më 29.12.2015, si dhe një pasuri tjetër në vlerë neto prej 1,820,206€, e regjistruar në vitin 2013 për banesat e kompleksit Hade 1 dhe 2 në Kastriot. Për këtë të fundit nuk janë siguruar vetëm pagesat që e përbëjnë vlerën e saj. Sipas zyrtarëve përkatës, ky dokumentacion nuk mund të gjendet. Pavarësisht kërkesave të përsëritura dhe përpjekjeve të vazhdueshme të ekipit të auditimit për sigurimin e dokumentacionit, deri në përfundim të auditimit nuk janë ofruar dokumentet e kërkuara. Si rrjedhojë, ekipi i auditimit nuk ka pasur mundësi të verifikojë saktësinë e këtyre regjistrimeve.

Mangësitë e evidentuara kanë ardhur si rezultat i mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive, përfshirë mungesën e monitorimit të rregullt të projekteve të përfunduara dhe moskoordinimin e mjaftueshëm ndërmjet njësive përkatëse (financa, pasuri dhe menaxherë të projekteve), si dhe mungesën e bashkëpunimit të mjaftueshëm me komunat përkatëse. Po ashtu, është vërejtur mungesë e njohurive të mjaftueshme për trajtimin e saktë të regjistrimeve dhe aplikimin e zhvlerësimit. Këto janë shoqëruar me mungesë të evidencave të plota në SIMFK, si dhe mungesë të rishikimeve periodike dhe veprimeve korrigjuese për çështje të përsëritura ndër vite.

## Ndikimi

Mangësitë në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive kanë ndikuar që pasqyrat financiare të mos paraqesin një gjendje të drejtë dhe të plotë të pasurive. Si rezultat, pasuritë kapitale janë mbivlerësuar, ndërsa në raste të caktuara janë evidentuar edhe nënvlerësime, duke ndikuar në saktësinë e raportimit financiar.

Po ashtu, mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit të mjaftueshëm me komunitat përkatëse ka ndikuar në mosregjistrimin dhe trajtimin jo të saktë të pasurive që kalojnë në pronësi të tyre. Mos sigurimi i dokumentacionit për dy lëndë ka kufizuar mundësinë e auditimit për të verifikuar saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve, duke rritur rrezikun që pasqyrat financiare të përmbajnë gabime materiale të pazbuluara

#### **Rekomandimi B2**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të forcojnë kontrollet e brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive dhe të sigurojnë koordinim më të mirë ndërmjet njësive përgjegjëse, si dhe bashkëpunim efektiv me komunitat përkatëse, me qëllim që projektet e përfunduara të transferohen në kohë në pasuri në përdorim dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu, duhet të sigurohet regjistrim i saktë dhe i plotë i pasurive, evidencë e plotë në SIMFK, si dhe rishikim periodik i regjistrimit për identifikimin dhe korrigjimin në kohë të pasaktësive, në mënyrë që të përmirësohet saktësia e raportimit financiar dhe të reduktohet rreziku për menaxhim joefektiv të pasurive.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontigjente në PFV**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 18 të Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për efektin neto në 7,141€<sup>1</sup>, si rezultat i mangësive si në vijim:

- Në një rast, vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e ulët se ajo e prezantuar në PFV, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve kontigjente në vlerë prej 37,417€;
- Në një rast tjetër, vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e lartë se ajo e prezantuar në PFV, duke rezultuar në nënvlerësim të detyrimeve kontigjente në vlerë prej 30,275€;
- Në një rast, për padinë e prezantuar në PFV në vlerë prej 180,000€, si dëshmi janë ofruar vetëm aktgjykime ku padia është refuzuar, ndërsa nuk janë siguruar dokumente të tjera mbështetëse që arsyetojnë vlerën e paraqitur në pasqyra. Sipas sqarimeve, dokumentacioni gjendet në Inspektoratin e Ministrisë dhe nuk ka qenë i siguruar gjatë auditimit; dhe
- Një padi pa vlerë financiare (e raportuar me zero) e cila ishte paguar dhe përfunduar vazhdon të paraqitet në PFV si detyrim kontigjent, ndonëse nuk plotëson më kushtet për t'u raportuar si e tillë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontigjente në PFV.

##### **Ndikimi**

Prezantimi i detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherit ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

**Rekomandimi B3** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë që të gjitha rastet gjyqësore të verifikohen rregullisht dhe të paraqiten saktë në pasqyrat financiare. Po ashtu, duhet të sigurohet dokumentacion i plotë për çdo rast dhe të hiqen nga raportimi rastet që janë përfunduar ose janë paguar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve**

**Gjetja** Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me Udhëzuesin e planit kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Shpenzimet ishin keq klasifikuar në vlerë prej 2,735,190€, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive jo adekuate. Përkatësisht:

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë realizuar 12 pagesa në vlerë prej 2,662,043€ për mallra dhe shërbime. Nga këto, katër raste në vlerë prej 632,184€ kanë të bëjnë me pagesën e shpronësimeve për pajtimet gjyqësore dhe aktvendimet e gjykatave ku janë përfshirë edhe shpenzimet e kamatës, tri pagesa në vlerë prej 1,122,537€ kanë të bëjnë me interesin dhe kamatën përmes pagesave përmes vendimeve gjyqësore, katër pagesa prej 438,494€ me sinjalizimin e rrugëve, si dhe një pagesë prej 468,827€ për prodhimin dhe instalimin e numrave të shtëpive; dhe

- Nga kategoria e mallra dhe shërbimeve ishin paguar tri pagesa në vlerë prej 73,147€. Një nga këto raste është në vlerë prej 23,375 e cila për nga natyra i takon investimeve kapitale, një pagesë në vlerë prej 10,038€ i takon subvencioneve dhe transfereve, dhe një pagesë në vlerë prej 39,734€ e cila është pagesë përmes vendimit gjyqësor dhe i takon shpronësimit që është dashur të realizohet nga investimet kapitale.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit si dhe realizimin e tij.

**Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata jo të sakta për lexuesit e PFV. Po ashtu, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike për vlerën e këtyre shpenzimeve.

**Rekomandimi B4** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Realizimi i projekteve rrugore pa u pajisur me leje ndërtimore

#### Gjetja

Sipas pikës 1 të nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-110 për ndërtim, Ministria ka kompetencë për lëshimin e lejeve për ndërtimet e kategorisë III (ndërtime me rrezikshmëri të lartë dhe me interes nacional), sipas Shtojcës Nr. 1 të këtij Ligji.

Sipas paragrafit 1, pika 1.14 të Shtojcës Nr. 1 të këtij Ligji, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është kompetente për dhënien e lejeve ndërtimore për rrugët shtetërore të rendit të parë dhe të dytë, objektet në shërbim të rrugëve, si dhe hyrjet në komunikacion në këto rrugë dhe në kalimet kufitare.

Gjatë auditimit, përmes rishikimit të procedurave të prokurimit dhe kontratave të nënshkruara, është konstatuar se në shtatë raste kontratat për ndërtimin, rehabilitimin, zgjerimin dhe rikonstruimin e rrugëve rajonale dhe nacionale janë nënshkruar gjatë vitit 2025 pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimore nga Ministria. Këto raste përfshijnë investime me vlerë të konsiderueshme financiare dhe tregojnë për një praktikë të përsëritur të fillimit të projekteve pa plotësimin e kushteve ligjore të nevojshme.

Rastet kanë ndodhur si rezultat i moszbatimit të kërkesave ligjore nga ana e Ministrisë për lëshimin e lejeve ndërtimore, si dhe mungesës së një mekanizmi funksional dhe kontrolleve efektive të brendshme për trajtimin dhe lëshimin e këtyre lejeve. Kjo ka bërë që projektet të realizohen pa u pajisur me leje ndërtimore në mënyrë sistematike.

#### Ndikimi

Realizimi i projekteve pa leje ndërtimore paraqet shkelje të kërkesave ligjore dhe rrit rrezikun për zbatim jo të rregullt të projekteve, mungesë të kontrollit institucional dhe ekspozim ndaj pasojave ligjore dhe financiare. Po ashtu, mungesa e lejeve ndërtimore mund të shkaktojë ndërprerje të punimeve të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në vonesa në realizimin e projekteve dhe rritje të kostove. Kjo gjithashtu mund të ndikojë në sigurinë dhe cilësinë e punimeve.

#### Rekomandimi A3

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të siguroj funksionalizimin e procesit për lëshimin e lejeve ndërtimore në përputhje me kërkesat ligjore, duke vendosur mekanizma të qartë dhe kontrolle efektive që garantojnë se asnjë projekt nuk fillon pa leje ndërtimore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A4 - Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave

#### Gjetja

Sipas nenit 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP-së), autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Në tri procedura të prokurimit, kemi vërejtur mangësi në procesin e

vlërësimit të tenderëve, si në vijim:

- Tek dosja e tenderit “Zgjerimi i rrugës Nacionale N9, Prishtinë-Pejë, segmenti Dollc - Zahaq, Loti 3”, me vlerë të kontratës prej 10,620,889€, në kërkesën nr. 5 për kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar që inxhinieri i diplomuar i gjeodezisë të ketë së paku tri vite përvojë pune pas diplomimit, ose Bachelor me së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit, si dhe përvojë në projekte të realizuara në fushën e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve. Si dëshmi për përmbushjen e këtyre kërkesave janë kërkuar: CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin dhe referencat për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Nga rishqyrtimi i dokumentacionit kemi vërejtur se OE nuk ka dëshmuar përvojën e kërkuar pas diplomimit.

- Tek dosja e tenderit “Rehabilitimi I rruges N25.2 segmenti Kishnic Bresallc”, me vlerë të kontratës prej 4,134,746€, në kërkesën 2 tek kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar, Udhëheqës i punishtës -Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv ose infrastrukture rrugore - tri vite përvojë pune pas diplomimit , si udhëheqës i punishtes në (ndertimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugeve), e dëshmuar përmes CV-së së nënshkruar, diplomës, kontratës së punës dhe referencave nga punëdhënësit. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit kemi vërejtur se i njëjti nuk i plotëson kriteret e kërkuara për përvojën prej tri vitesh pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes.

- Tek dosja e tenderit “Rregullimi i Shtratit te Lumit ne Fshatin Baballoq, K.Deçan”, me vlerë të kontratës prej 999,000€, në kërkesën 2.1 tek kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar Një Inxhinier i diplomuar apo Master i ndërtimtarisë me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit drejtimi hidroteknik, e dëshmuar përmes CV-së së nënshkruar, diplomës, kontratës së punës dhe referencave nga punëdhënësit. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit kemi vërejtur se i njëjti nuk i plotëson kriteret e kërkuara për përvojën prej pesë vitesh pas diplomimit.

Mangësitë e identifikuar kanë ardhur si rezultat i vlerësimit jo të plotë dhe jo të saktë të dokumentacionit nga komisionet përkatëse, si dhe interpretimit jo të njëtrajtshëm të kriterëve të përcaktuara në dosjet e tenderit. Po ashtu, mungesa e kontrollit efektiv të brendshëm ka ndikuar në mosidentifikimin dhe korrigjimin me kohë të këtyre mangësive gjatë procesit të vlerësimit.

#### **Ndikimi**

Mangësitë e lartpërmendura rrisin rrezikun për realizim jo cilësor të kontratave dhe për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale. Kjo ndikon negativisht në besueshmërinë dhe funksionimin e rregullt të procesit të prokurimit publik.

#### **Rekomandimi A4**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë forcimin e kontroleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojnë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A5 - Mangësi në trajtimin e kërkesave dhe mosrespektim i afateve ligjore në trajtimin e aplikimeve për leje dhe pëlqime mjedisore****Gjetja**

Neni 18, pika 3 e Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përcakton se: “Vendimi për pëlqimin mjedisor përgatitet nga Komisioni i VNM-së brenda 90 ditësh nga pranimi i raportit të VNM-së dhe pas përfundimit të periudhës së debatit publik”.

Ndërkaq, neni 10, pika 1 e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2022 për Leje Mjedisore përcakton se: “Komisioni kontrollon lëndën nëse është e plotësuar në aspektin administrativ brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës”.

Gjatë auditimit janë evidentuar mangësi në trajtimin e aplikimeve për pëlqime dhe leje mjedisore, veçanërisht në respektimin e afateve ligjore dhe organizimin e procesit shqyrtues. Konkretisht:

- Nga dy mostrat e testuara për pëlqime mjedisore, kemi vërejtur se në njërin rast vendimi është përgatitur me vonesë prej 116 ditësh (26 ditë mbi afatin ligjor) nga Komisioni i VNM-së, ndërsa vendimi përfundimtar për pëlqim mjedisor është nxjerrë pas 148 ditësh (58 ditë mbi afatin e përcaktuar me ligj), duke tejkaluar afatet kohore të përcaktuara.

- Sa i përket lejeve mjedisore, nga tri mostrat e testuara kemi konstatuar se në të gjitha rastet ka pasur vonesa prej 75 deri në 80 ditë në trajtimin e aplikimeve, përkatësisht në fillimin e shqyrtimit të dokumentacionit nga momenti i pranimit të aplikacionit.

- Gjithashtu, tek lejet mjedisore në të tri rastet është konstatuar se, ndonëse komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, vizitat në teren, të cilat janë obligative, janë realizuar vetëm nga dy anëtarë të komisionit. Kjo praktikë nuk siguron përfshirje të plotë të komisionit në një nga fazat kyçe të procesit vlerësues.

Sipas Ministrisë, këto mangësi kanë ardhur si rezultat i numrit të madh të lëndëve për trajtim dhe kapaciteteve të pamjaftueshme për shqyrtimin e tyre brenda afateve të përcaktuara ligjore. Ndërkohë, ka munguar monitorimi efektiv i afateve ligjore dhe koordinim jo i plotë brenda komisionit përgjegjës për vlerësimin e aplikimeve.

**Ndikimi**

Mosrespektimi i afateve ligjore në trajtimin e aplikimeve ndikon në vonesën e proceseve administrative dhe krijon pasiguri për operatorët ekonomikë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të tyre.

**Rekomandimi A5**

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndërmarrë masa për të siguruar trajtim në kohë të aplikimeve për pëlqime dhe leje mjedisore, në përputhje me afatet ligjore, përmes përmirësimit të organizimit të procesit shqyrtues, rritjes së efikasitetit dhe sigurimit të përfshirjes së plotë të komisioneve në të gjitha fazat e procesit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A6 - Aplikim i gabuar i peshimit të çmimeve dhe i pragut  $\pm 30\%$  në kontratë****Gjetja**

Neni 54, pika 15 e Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik përcakton se, kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve/artikujve" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%). Sipas dosjes së tenderit, nënkriteret e dhënies janë: kapaciteti teknik dhe profesional 0.80%, ndërsa oferta financiare 0.20%.

Në projektin "Ri-tender shërbime inxhinierike profesionale - mbikëqyrja", Ministria ka përdorur kontratë publike kornizë dhe ka aplikuar metodën e peshimit të çmimeve gjatë vlerësimit të ofertave, përmes çmimeve të poentuara sipas peshës së secilit pozicion. Megjithatë, në nenin 3 të kontratës janë përfshirë njëkohësisht disa elemente, përkatësisht: çmimet njësi të poentuara (12.92%), çmimet njësi të pa poentuara (33%) për të gjitha pozicionet, si dhe vlera totale e kontratës prej 550,000€, e shoqëruar me devijimin e lejuar  $\pm 30\%$ .

Përfshirja e pragut  $\pm 30\%$  në këtë rast është në kundërshtim me rregulloren, pasi në kontratat me çmime për njësi, ku vlerësimi bëhet përmes çmimeve të poentuara, nuk lejohet përdorimi i këtij pragu.

Përfshirja e njëkohshme e çmimeve të poentuara, çmimeve të pa poentuara dhe pragut  $\pm 30\%$  në kontratë tregon për mungesë të qartësisë dhe kontrollit në hartimin e dokumenteve kontraktuale, si dhe moszbatim të saktë të kërkesave të rregullores për kontratat me çmime për njësi.

**Ndikimi**

Përfshirja e elementeve të papajtueshme në kontratë rrit rrezikun për zbatim jo të drejtë të saj dhe krijon paqartësi në menaxhimin e kontratës. Po ashtu, përdorimi i pragut  $\pm 30\%$  në kundërshtim me rregulloren cenon parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

**Rekomandimi A6**

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të siguroj që në kontratat me çmime për njësi, ku aplikohet peshimi i çmimeve të poentuara, të mos përfshihet pragu  $\pm 30\%$ , në përputhje me kërkesat e rregullores. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet gjatë hartimit dhe rishikimit të kontratave për të siguruar që elementet e përfshira janë të qarta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A7 - Vonesat në pagesën e faturave****Gjetja**

Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime të furnizuara dhe/ose punë të realizuara, të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e pranimit të tyre nga organizata buxhetore.

Janë evidentuar se në dy raste të investimeve kapitale, në vlerë prej 1,267,607€, dhe në dy raste të mallrave dhe shërbimeve, në vlerë prej 753,693€, faturat janë paguar me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në realizimin e pagesave variojnë nga 24 deri në 108 ditë. Dy rastet nga investimet kapitale i përkasin fushës së infrastrukturës, ndërsa dy rastet nga mallrat dhe shërbimet lidhen me Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore.

Këto vonesa kanë ndodhur si rezultat i mungesës së fondeve të mjaftueshme në kategoritë përkatëse ekonomike.

**Ndikimi** Vonesat në pagesën e faturave ndikojnë negativisht në realizimin e buxhetit sipas planifikimeve dhe mund të shkaktojnë kosto shtesë për buxhetin e Ministrisë, përfshirë kamatat për vonesë dhe shpenzimet nga procedurat përbarimore.

**Rekomandimi A7** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndërmarrin masa për forcimin e kontroleve të brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave dhe të sigurojnë që të gjitha faturat e vlefshme të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B5 - Tejkallim dhe mosrealizim i sasive në kontrata për mirëmbajtje të rrugëve**

**Gjetja** Neni 70, pika 17 e Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik përcakton se, Menaxheri i kontratës do t'i raportojë Departamentit të Prokurimit: (a) për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës, si dhe neni 54.15 përcakton se, kontrata që lidhet me çmime për njësi mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

Në tri raste kemi identifikuar se Ministria ka përdorur kontrata publike kornizë me çmim për njësi, ku janë evidentuar njëkohësisht tejkallime dhe mosrealizime të sasive brenda të njëjtave kontrata, me qëllim të mos tejkallimit të vlerës së përgjithshme të kontraktuar. Ndërsa, në një rast është konstatuar tejkallim i sasive dhe i vlerës së kontratës në masën prej 21%. Në total, tejkallimi i sasive në këto kontrata arrin në 1,281,497€, ndërsa mosrealizimi i sasive të planifikuara në disa pozicione arrin në 688,243€, duke reflektuar mangësi në planifikimin e nevojave dhe në menaxhimin e kontratave.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i planifikimit jo të saktë të nevojave për mirëmbajtje të rrugëve, interpretimit jo të duhur të dispozitave që rregullojnë kontratat me çmime për njësi, si dhe mungesës së monitorimit dhe kontrollit efektiv nga menaxherët e kontratave gjatë zbatimit të tyre.

**Ndikimi** Tejkallimi dhe mosrealizimi i sasive kanë ndikuar në menaxhim joefektiv të kontratave dhe shpenzimeve publike, duke rritur rrezikun për përdorim jo racional të buxhetit dhe devijim nga kushtet kontraktuale.

**Rekomandimi B5** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të siguroj përmes zyrtarëve përgjegjës përmirësimin e planifikimit të nevojave për mirëmbajtje të rrugëve, duke bazuar sasitë indikative në analiza reale dhe të qëndrueshme. Po ashtu, duhet të siguroj zbatim të plotë të kërkesave

ligjore për kontratat me çmime për njësi, si dhe të forcoj monitorimin dhe raportimin nga menaxherët e kontratave për të parandaluar tejkalimet dhe mosrealizimet e sasive.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C1 - Ndryshime në sasi të e paramasës pa aprovim paraprak**

- Gjetja** Sipas nenit 71.1 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit.
- Gjatë auditimit janë evidentuar dy kontrata në të cilat janë bërë ndryshime në sasi të e kontraktuara, duke rritur ose zvogëluar sasinë e realizuar, pa ndryshuar vlerën totale të kontratës. Ndryshimet përfshijnë nga një deri në 38 pozicione të rritura, në vlerë deri në 235,815€, si dhe 16 pozicione për të cilat nuk është realizuar asnjë punë. Për këto ndryshime nuk janë marrë aprovimet e nevojshme nga ZKA.
- Këto kishin ndodhur si rezultat i mosfiksionimit të kontrolleve në menaxhimin e kontratave, mos planifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe ndryshimeve në kushtet e terrenit me mendimin për t'i bërë projektet më funksionale.
- Ndikimi** Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar në mungesë të aprovimeve të duhura rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë në pajtim me kërkesat e projektit. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera dhe në përmbushjen e kontratës sipas objektivave të përcaktuara si dhe rrit mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasën e tenderit fillestar.
- Rekomandimi C1** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të siguroj që çdo ndryshim në paramasë të bëhet vetëm pas analizave të nevojshme dhe aprovimeve paraprake, në përputhje me dispozitat ligjore dhe kontraktuale. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet në menaxhimin e kontratave dhe të përmirësohet planifikimi i projekteve, në mënyrë që të minimizohen ndryshimet gjatë zbatimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 5,521,190€, ndërsa realizimi për vitin 2025 arriti në 5,511,947€, që përfaqëson 99.8% të buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara sipas Ligjit të Buxhetit ishte 636, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 562.

#### Çështja A8 - Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

<b>Gjetja</b>	<p>Sipas Ligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, konkretisht paragrafi 3 i nenit 35 të ligjit bazik riformulohet si vijon: “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj, përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur, por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. Ndërkaq, paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.</p> <p>Gjatë auditimit kemi vërejtur se në katër raste, në pjesën e mjedisit është tejkalluar afati ligjor për mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre. Tejkallimet variojnë nga dy vite deri në tri vjet e 11 muaj, përtej afatit të lejuar me ligj.</p> <p>Zgjatja përtej afatit ligjor e ushtrimit të detyrës në pozita drejtuese ka ardhur si rezultat i mosndërmarrjes së masave të mjaftueshme nga menaxhmenti për adresimin e situatës dhe mungesës së angazhimit të duhur për mbulimin e këtyre pozitave.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mbajtja e pozitave drejtuese me ushtrues detyre përtej periudhës së përcaktuar me ligj përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe rrezikon që këto pozita të udhëhiqen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për atë pozitë.</p>
<b>Rekomandimi A8</b>	<p>Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitën që aktualisht mbulohet me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A9 - Dhënia e shtesave për vëllim të punës pa përmbushje të kriterëve ligjore****Gjetja**

Sipas nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, shtesat në pagë mund të jepen vetëm në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Sipas nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, kriteret për përfitimin e shtesave janë: Nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Përfundimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se shtesat për vëllim të punës, në vlerë totale prej 4,619€, janë dhënë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi nuk është dëshmuar përmbushja e kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si në vijim:

- Në një rast, një zyrtar ka përfituar shtesë për angazhime si: koordinim për publikimin e dokumenteve zyrtare, përditësim i ueb-faqes së Ministrisë, takime me përfaqësues institucionalë, raportim vjetor dhe mbikëqyrje të menaxherëve të kontratave. Marrëveshja është lidhur më 28.08.2025 për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, ndërsa pagesa e realizuar në muajin nëntor ishte 1,613€.

- Një zyrtar ka përfituar shtesë në vlerë prej 1,373€ për angazhime si: organizim i punës, dhënie e këshillave ligjore dhe pjesëmarrje në komisione të brendshme. Marrëveshja është lidhur për periudhën retroaktive 01.01.2024-31.12.2024.

- Një zyrtar tjetër ka përfituar shtesë për angazhimin si pikë kontaktuese për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, për koordinim dhe komunikim institucional. Marrëveshja është lidhur më 30.07.2025 për periudhën retroaktive 01.01.2025-31.12.2025, ndërsa pagesa për 11 muaj ishte 1,633€.

Në të gjitha rastet, nuk është dëshmuar se janë përmbushur kriteret kumulative të përcaktuara me Rregulloren nr. 10/2023 për përfitimin e kompensimit për funksion shtesë. Për më tepër, lidhja e marrëveshjeve me efekt retroaktiv rrit rrezikun për pagesa të paarsyetuara dhe jo të mbështetura në mënyrë adekuate.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore lidhur me dhënien e shtesave për vëllim të punës dhe funksionin

shtesë mungesës së kontrollit nga nivelet menaxheriale para aprovimit të këtyre shtesave.

**Ndikimi**

Dhënia e shtesave pa përmbushje të kriterëve ligjore rezulton në shpenzime të parregullta të Ministrisë, krijon trajtim jo të barabartë të punonjësve dhe rrit rrezikun për krijimin e praktikave të paqëndrueshme në menaxhimin e pagave.

**Rekomandimi A9**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë që shtesat për vëllim të punës të jepen vetëm në rastet kur dëshmohet qartë rritja reale e ngarkesës në punë dhe kur ato janë në përputhje të plotë me rregullativen ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 244,349,661€, prej të cilave gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 179,912,130€, që përfaqëson 74% të buxhetit. Këto shpenzime lidhen kryesisht me ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve, pagesat për shpronësimin e tokave, bashkëfinancimin e projekteve në bazë të memorandumeve me komunat, si dhe rregullimin e lumenjve dhe projekte të tjera infrastrukturore.

### Çështja A10 - Dobësi në zbatimin e projekteve kapitale gjatë verifikimit në terren

#### Gjetja

Sipas paragrafit 1 të nenit 31 të Ligjit të Prokurimit Publik (Ekzekutimi i kontratave) përcaktohet se Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit shtatë dhe janë paraqitur në dosjen e tenderit.

Sipas paragrafit 1 nenit 69 të këtij Ligji në lidhje me aftësitë teknike dhe/ose profesionale theksohet se Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Ndërsa, Sipas nenit 30 të këtij Ligji në lidhje me nën-kontraktimin, Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Gjithashtu, sipas pikës 4.2 të kontratës në mes Ministrisë dhe OE, elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve duhet të bëhen të ditura në momentin e dorëzimit të ofertës, ndërsa çdo nënkontraktim gjatë zbatimit të kontratës kërkon njoftim me shkrim dhe miratim nga Autoriteti Kontraktues, i cili duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve pune. Po ashtu, nënkontraktuesit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

Po ashtu, punimet duhet të realizohen në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike të kontratës.

Gjatë verifikimit fizik të projekteve kapitale, janë identifikuar mangësi që lidhen me zbatimin e kontratave dhe mbikëqyrjen e punimeve, si në vijim:

1. Te projekti “Ndërtimi i mbikalimeve (urave) për këmbësorë dhe automjete në Mitrovicë”, kontrata e nënshkruar në vlerë prej 2,999,628€ me datë 01.07.2025, gjatë vizitës në terren të realizuar më 24.03.2026, janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Menaxheri i projektit i angazhuar në terren nuk ishte i njëjtë me menaxherin e deklaruar në ofertën e operatorit ekonomik fitues, duke devijuar nga kapacitetet profesionale të vlerësuara gjatë tenderimit.
- Nga rishikimi i dokumentacionit, kemi vërejtur se punimet lidhur me armaturën dhe betonin janë realizuar nga një palë e tretë (nënkontraktues). Megjithatë, për këtë angazhim nuk është ndjekur procedura e përcaktuar në kontratë, pasi nuk ka pasur njoftim zyrtar me shkrim dhe as miratim paraprak nga Autoriteti Kontraktues.
- Gjatë verifikimit në terren është vërejtur se në dy pozicione të kontratës është vendosur mbishkrimi i kompanisë që ka kryer punimet (nënkontraktuesit). Ky element nuk ka qenë i paraparë në projektin dhe

specifikimet teknike, prandaj paraqet devijim nga projekti i miratuar.  
 - Për këtë projekt është nënshkruar aneks-kontratë më 29.12.2025. Sipas kushteve të kontratës, punimet duhet të fillonin me datën e nënshkrimit, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike të pafavorshme ishte paraparë që fillimi i punimeve të bëhej pas lëshimit të letrës për fillimin e punimeve nga menaxheri i projektit, e cila është lëshuar më 13.03.2026. Megjithatë, gjatë vizitës në terren është konstatuar se punët e dheut (Pozicioni 2), punët për largimin e ujërave atmosferik (pozicioni 6) dhe punët e asfaltit (pozicioni 7) përfshira në aneks-kontratë kishin përfunduar. Nga sqarimet dhe dëshmitë e siguruara rezulton se këto punë ishin realizuar së bashku me punët e kontratës bazë, përkatësisht para nënshkrimit të aneks-kontratës. Kjo ka ndodhur pasi që këto punime nuk kanë qenë të përfshira në projektin bazë, dhe mungesa e tyre do të rezultonte që ura të mbetej e pashfrytëzueshme.

2. Te projekti “Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë - Kyçja në Autostradën dr. Ibrahim Rugova në Prizren - Jug, L=20.35 km, LOT 1 (L=6+913.73 km)” kontrata e nënshkruar më 02.08.2024 në vlerë prej 7,999,999€, gjatë verifikimit fizik të kryer më 25.03.2026, është vërejtur se menaxheri i projektit dhe udhëheqësi i punishtes të angazhuar në terren nuk ishin të njëjtë me personat e deklaruar në ofertën e OE fitues. Kjo tregon se stafi kyç i paraqitur për të dëshmuar kapacitetin profesional gjatë procedurës së tenderimit nuk ishte i njëjtë me stafin që po e zbatonte kontratën në praktikë.

3. Te projekti “Ndërtimi i Autoudhës A7.1 - Kryqëzimi me disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Dheu i Bardhë - pjesa: kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Udhëkryqi ‘Bresalc’, L=22.31 km, LOT 8”, kontrata e nënshkruar më 13.02.2018 në vlerë prej 11,913,157€. Gjatë verifikimit është konstatuar se disa pozicione janë përfshirë në situacion për pagesë, ndonëse nuk janë realizuar/kompletuar në terren. Konkretisht:

- Pozicioni 4.8 (Furnizimi, transporti dhe punimi i pusetës me dimensione 200x200x200cm nga betoni i armuar, i lyer me material hidroizolues, kapaku i së cilës është metalik në formë katrore prej materialit të derdhur me dimensione 65x65cm, që do të jetë për nevoja të shpërndarjes së kabllove të tensionit), 71 copë me vlerë 39,050€ është paguar, ndërsa në terren nuk është i kompletuar (mungojnë kapakët metalik).

- Pozicioni 8.1.6 (Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave metalike të galvanizuara të ndriqimit, në formë të shkronjës V me lartësi 8.5m (për shesh-pagesë) me derë për hapje, formë dhe trashësi të mureve dhe pamje të dhenë si në pjesën grafike si dhe furnizimi trans) 15 copë me vlerë 4,200€ janë paguar, ndërsa nuk është realizuar në terren.

Rastet e identifikuara tregojnë se gjatë zbatimit të projekteve kapitale nuk është ushtruar kontroll i mjaftueshëm nga Ministria dhe menaxherët e projekteve gjatë zbatimit të kontratave.

Mangësitë e identifikuara kanë ardhur si rezultat i mungesës së kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive gjatë zbatimit të kontratave, që ka reflektuar në: mosverifikimin e stafit kyç të angazhuar në projekte në përputhje me ofertën; moszbatimin e procedurave për nënkontraktim dhe mungesën e miratimeve paraprake; lejimin e devijimeve nga projekti dhe specifikimet teknike; si dhe pranimin dhe pagesën e punimeve pa u siguruar për realizimin e plotë të tyre në terren apo pa formalizim paraprak përmes aneks-kontratave.

dhe në cilësinë e punimeve të realizuara. Mosrespektimi i kushteve kontraktuale dhe procedurave përkatëse mund të ndikoj në realizim të projekteve me standarde të ulëta, si dhe në pranimin dhe pagesën e punimeve që nuk janë kryer sipas kërkesave. Kjo rrit rrezikun për kosto shtesë në të ardhmen dhe ul efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

**Rekomandimi A10** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të siguroj zbatim të rregullt të kontratave përmes forcimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit gjatë realizimit të projekteve kapitale. Në veçanti, duhet të garantojë që stafi kyç i angazhuar në projekte të jetë në përputhje me ofertën, çdo nënkontraktim të miratohet paraprakisht, punimet të realizohen sipas projektit dhe specifikimeve teknike, si dhe pagesat të bazohen vetëm në punë të kryera dhe të verifikuara. Gjithashtu, çdo ndryshim apo punë shtesë duhet të formalizohet paraprakisht në përputhje me kushtet e kontratës dhe legjislacionin në fuqi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A11 - Mungesë e kërimit të sqarimeve për ofertat me çmime jo normalisht të ulëta

**Gjetja** Sipas nenit 61 (për tenderët jo-jormalisht të ulët) të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik përcaktohet që nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Gjatë shqyrtimit të dosjes së tenderit për projektin “Ndërtimi i rrugës rajonale R118, segmenti Mushtisht-Shtërpçë, pjesa nga km 13+000 deri në km 18+059.60 (L=5,059.60m)”, për kontratën e nënshkruar më 24.06.2025 në vlerë prej 2,970,000€, kemi vërejtur se OE fitues ka ofertuar me çmime shumë të ulëta në disa pozicione të paramasës.

Konkretisht, në këta zëra janë ofruar çmime si në vijim:

- Pozicioni 1.4 “Konstruksioni i trasës”, pika 1.4.1 - furnizimi, bartja dhe shtrirja e rërës si mbrojtje e gjeotekstitit ( $t=5 \text{ cm/m}^3$ ) me çmim 1€;
- Pozicioni 1.6 “Lëshesat rrethore”, pika 1.6.6 - fi 600 me çmim 1€, fi 1000 me çmim 130€, si dhe dy fi 1000 me çmim 1€.

Për këto çmime shumë të ulëta, komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim me shkrim nga operatori ekonomik për arsyetimin e tyre, siç kërkohet me legjislacionin për prokurimin publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive në kontrollet e brendshme dhe në zbatimin e kërkesave të legjislacionit për prokurimin publik nga ana e Ministrisë.

**Ndikimi** Mos kërkitimi i sqarimeve për çmime të ulëta mund të rezultojë në mosrealizim të kontratës sipas kushteve të parapara dhe të ndikojë negativisht në cilësinë e punimeve. Njëkohësisht, kjo cenon transparencën, konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë në procedurat e prokurimit publik.

**Rekomandimi A11** Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të kërkesave të

legjislacionit për prokurimin publik, duke kërkuar me kohë sqarime me shkrim nga operatorët ekonomikë në rastet kur ofertat përmbajnë çmime shumë të ulëta. Kjo do të mundësojë një vlerësim më të drejtë të ofertave dhe do të zvogëlojë rrezikun e mosrealizimit të kontratave sipas kushteve të parapara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

##### **Çështja A12 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit**

#### **Gjetja**

Neni 70.24 pika (f) e Rregullorës Nr. 001/2022 për prokurimin publik, parasheh se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Nga testimet e bëra ka rezultuar se në pesë raste monitorimi i kontratave nuk është mbajtur përmes sistemit elektronik të e-prokurimit. Katër prej tyre janë në pjesën e infrastrukturës, ndërsa një rast në pjesën e mjedisit.

Mospërdorimi i sistemit ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurës së përcaktuar nga rregullorja, për shkak të mungesës së përgjegjësisë administrative nga ana e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e kontratave.

#### **Ndikimi**

Mos mbajtja e kontratave përmes sistemit elektronik të e-prokurimit mund të ndikojë në menaxhim jo të mirë të kontratave dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit të tjerë të lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e performancës të kontratave.

#### **Rekomandimi A12**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të ndërmerren masa për forcimin e disiplinës administrative dhe monitorimit të brendshëm, në mënyrë që zyrtarët përgjegjës të përmbushin detyrimet që dalin nga legjislacioni në fuqi.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

##### **Çështja B6 - Vonesa në realizimin e projekteve**

#### **Gjetja**

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet ministrisë dhe operatorëve ekonomikë përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në katër raste, kemi vërejtur se punimet nuk janë realizuar sipas planit dinamik, siç është paraparë me kontratë. Rastet e identifikuara janë:

- Kontrata “Sanimi emergjent të rrëshqitjeve në rrugën Nacionale N9 Segmenti Pejë - Kuqishtë”, në vlerë 1,577,994€ ishte nënshkruar me datë 12.02.2025. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte pesë ditë nga nënshkrimi i kontratës, dhe përfundimi për 145 ditë pune. Deri gjatë kohës sa ne ishim në auditim (mars 2026) punimet nuk kanë përfunduar ende.

- Kontrata “Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë - Besi - Podujevë,

LOT 3”, në vlerë prej 9,254,811€, është nënshkruar më 19.06.2023. Sipas kontratës, afati për përfundimin e punimeve ishte 317 ditë nga data e nënshkrimit, përkatësisht deri në tetor 2024. Për këtë projekt janë nënshkruar edhe dy aneks-kontrata, me vlerë të përbashkët prej 864,390€, të cilat kanë paraparë një afat shtesë prej 30 ditë pune. Megjithatë, deri gjatë kohës sa ne ishim në auditim (mars 2026) punimet nuk kanë përfunduar ende.

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë - Kycja në Autostradën dr. Ibrahim Rugova në Prizren - Jug, L=20.35 km, LOT 1 (L=6+913.73 km)” është nënshkruar më 02.08.2024, në vlerë prej 7,999,999€. Sipas kontratës, afati për përfundimin e punimeve është 255 ditë pune nga data e fillimit. Punimet kanë filluar në të njëjtën datë, më 02.08.2024. Për këtë projekt është nënshkruar edhe një aneks-kontratë në vlerë prej 653,715€, me afat shtesë prej 140 ditë pune nga data 16.04.2025, respektivisht deri në nëntor 2025. Megjithatë, deri gjatë kohës sa ne ishim në auditim (mars 2026) punimet nuk kanë përfunduar ende.

- Kontrata “Ndërtimi i Autoudhës A7.1 - Kryqëzimi me disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Dheu i Bardhë - pjesa: kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) - Udhëkryqi ‘Bresalc’, L=22.31 km, LOT 8”, e nënshkruar më 13.02.2018 në vlerë prej 11,913,157€ dhe po të njëjtën ditë kanë filluar punimet me një afat për përfundimin e punimeve 30 muaj nga fillimi i punimeve. Megjithatë, deri gjatë kohës sa ne ishim në auditim (mars 2026) punimet nuk kanë përfunduar ende.

Vonesat në realizimin e projekteve kanë ardhur si rezultat i një kombinimi faktorësh, përfshirë problemet në procesin e shpronësimit dhe çështjet pronësore, rrëshqitjet dhe shembjet e dheut, si dhe mangësitë në planifikimin fillestar të projekteve, të cilat kanë rezultuar me ndryshime në paramasë dhe paralogari gjatë zbatimit. Po ashtu, gjatë realizimit janë paraqitur elemente dhe infrastrukturë e paplanifikuar në terren, që ka kërkuar ndërhyrje shtesë dhe përshtatje teknike. Në këto vonesa kanë ndikuar edhe kushtet e pafavorshme atmosferike gjatë periudhës së realizimit.

#### **Ndikimi**

Vonesat në realizimin e projekteve bëjnë që përfitimet për qytetarët të vonohen dhe projektet të mos përfundojnë sipas planit. Kjo mund të sjellë edhe rritje të kostove për shkak të punimeve shtesë dhe zgjatjes së afateve, duke ndikuar në përdorimin joefikas të fondeve publike. Po ashtu, këto vonesa vështirësojnë planifikimin dhe zbatimin e projekteve të tjera kapitale.

#### **Rekomandimi B6**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të përmirësoj planifikimin fillestar të projekteve, duke siguruar që të gjitha çështjet pronësore, teknike dhe infrastrukturale të jenë trajtuar para fillimit të punimeve. Po ashtu, duhet të forcoj monitorimin e zbatimit të kontratave dhe të ndërmarrë masa me kohë në rast të devijimeve nga plani dinamik, me qëllim që projektet të realizohen brenda afateve të përcaktuara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore****Gjetja**

Neni 39.1 i LMFPP Nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë. Po ashtu, edhe neni 40.1 thekson “Kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhëri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhërit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë”.

Pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore në vitin 2025 ishin 5,513,738€ dhe në përgjithësi kanë të bëjnë me pagesën e shpronësimeve. Tek investimet kapitale, në tri mostra të testuara në vlerë prej 1,933,150€, shpenzimet për borxhin kryesor ishin 1,464,809€, ndërsa shpenzime shtesë për kamatë dhe procedura gjyqësore janë në vlerë prej 468,341€.

Kjo dukuri ka ndodhur kryesisht si rezultat i ankesave të shumta ndër vite të palëve të pakënaqura me vlerësimin e pronave në vendimin përfundimtar të shpronësimit.

**Ndikimi**

Kjo situatë ka rezultuar me rritjen e kostos së ministrisë duke krijuar vështirësi në realizimin e projekteve të aprovuara për vitin përkatës/vijues.

**Rekomandimi B7**

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B8 - Mangësi në pagesën me kohë dhe aplikimin e interesit për shpronësimet****Gjetja**

Neni 16.2 i Ligjit Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme përcakton “Organi shpronësues ia paguar, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose përfituesi i prituri, nëse ka të këtillë, që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin përfundimtar, pronarit të prekur ose zotëruesit të interesit. Kompensimi i kërkuar në vendimin përfundimtar do të jetë: 2.1. shumën e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 2.2 interesin në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.

Ndërkaq, sipas pikës shtatë të Vendimit përfundimtar të miratuar theksohet se brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departmenti i shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të caktuar në raportet e vlerësimit konform legjislacionit në fuqi.

Në katër (4) raste të testuara, në vlerë prej 115,386€, janë evidentuar vonesa në pagesën e shpronësimeve prej katër (4) deri në trembëdhjetë

(13) muaj pas datës së Vendimit përfundimtar, ndërsa nga data e aplikimit deri në pagesë vonesat kanë qenë nga tri deri në shtatë muaj. Përveç rasteve të bazuara në vendime gjyqësore/përmbarrimore apo pajtime gjyqësore, Ministria nuk ka aplikuar interesin ligjor prej 7% për vonesat në kompensimin e pronarëve të tokave të shpronësuara.

Vlera totale e pagesave të realizuara gjatë vitit 2025, të cilat nuk janë bazuar në vendime gjyqësore/përmbarrimore, është 6,787,813€, duke përfshirë edhe pagesat e realizuara në llogarinë e fondit të mirëbesimit në BQK.

Kjo ka ndodhur si rezultat i interpretimit jo të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore dhe të Vendimit përfundimtar, veçanërisht lidhur me kohën e realizimit të pagesës. Po ashtu, Ministria është përballur me mungesë të mjeteve buxhetore, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre është shpenzuar për pagesa që rrjedhin nga vendime gjyqësore/përmbarrimore dhe pajtime gjyqësore, duke ndikuar në vonesat e pagesave të tjera të shpronësimeve. Mungesa e një kornize të përditësuar ligjore ka ndikuar gjithashtu në trajtimin jo të njëjtë të rasteve, pasi projektligji i ri për shpronësimin ende nuk është miratuar.

**Ndikimi** Vonesat në pagesat e shpronësimeve dhe mosaplikimi i interesit ligjor prej 7% mund të rezultojnë në trajtim jo të barabartë të pronarëve dhe të rrisin rrezikun për konteste gjyqësore dhe kosto shtesë për buxhetin e Ministrisë.

**Rekomandimi B8** Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojë që pagesat e shpronësimeve të realizohen në përputhje me afatet ligjore dhe të aplikohet interesi ligjor prej 7% në rastet e vonesave. Gjithashtu, duhet të sigurohet planifikim më i mirë buxhetor për të përmbushur detyrimet në kohë dhe të forcohen kontrollet e brendshme për të garantuar zbatim të njëtrajtshëm të kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV ishte 2,040,685,556€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 86,072€ dhe e stoqeve 169,077€.

#### Çështja C2 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

##### Gjetja

Neni 19.4.3 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Mangësitë e identifikuara në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare janë si në vijim:

- Megjithëse janë nxjerrë vendimet për themelimin e komisioneve për inventarizim të pasurive, procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare nuk është përfunduar në plotësi. Si rrjedhojë, nuk është realizuar krahasimi ndërmjet gjendjes kontabël dhe gjendjes faktike të inventarit. Raportimi i pasurive në PFV është bazuar vetëm në regjistrat kontabël.

- Sipas raportit të komisionit të inventarizimit për pjesën e mjedisit dhe ambientit, të datës 15.01.2026, një pjesë e inventarit është konstatuar si e stërvjetruar dhe jashtë përdorimit, për të cilën janë dhënë rekomandime për shkarkim dhe asgjësim. Megjithatë, komisioni i caktuar për vlerësim nuk e kishte përfunduar procesin, rrjedhimisht nuk janë ndërmarrë veprimet e mëtejshme për largimin dhe asgjësimin e këtij inventari.

- Komisioni i inventarizimit, në raportin e datës 14.01.2026 për pjesën e infrastrukturës, ka dhënë rekomandime për inventarin që duhet të shkarkohet, pasi është jashtë përdorimit. Megjithatë, këto rekomandime nuk janë zbatuar, pasi komisioni i vlerësimit nuk ishte formuar dhe nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme.

- Më datë 26.12.2025, në Drejtorinë e Menaxhimit të Rrugëve, komisioni për asgjësimin e inventarit ka kryer asgjësimin e inventarit të vjetër dhe jashtë përdorimit. Megjithatë, ky inventar nuk është larguar nga regjistrat e e-pasurisë dhe ende rezulton i regjistruar në regjister.

Mangësitë e identifikuara kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare, mungesës së koordinimit ndërmjet komisioneve përgjegjëse dhe zyrtarëve të pasurisë, si dhe mos ndjekjes së rekomandimeve të komisioneve për inventarizim dhe asgjësim. Gjithashtu, kontrollet e brendshme në këtë proces nuk kanë qenë efektive për të siguruar përditësimin e saktë dhe me kohë të regjistrave të pasurisë.

##### Ndikimi

Mangësitë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, si dhe moszbatimi i rekomandimeve për shkarkim dhe asgjësim, kanë rezultuar në mospërputhje ndërmjet gjendjes faktike dhe asaj kontabël të pasurive. Si pasojë, raportimi në PFV është bazuar në të dhëna jo të përditësuara, duke rritur rrezikun e paraqitjes së pasaktë të pasurive. Për më tepër, mbajtja në regjistra e pasurive të asgjësuar apo jashtë përdorimit, si dhe moskryerja e

vlerësimit, mund të çojë në mbivlerësim të pasurive dhe dobësim të menaxhimit dhe kontrollit mbi to

## Rekomandimi C2

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare, duke përfunduar procesin e inventarizimit dhe duke realizuar krahasimin ndërmjet gjendjes faktike dhe asaj kontabël. Po ashtu, duhet të sigurohet funksionalizimi i komisioneve për vlerësim dhe zbatimin e rekomandimeve për shkarkimin dhe asgjësimin e pasurive jashtë përdorimit. Gjithashtu duhet të përditësohet regjistrat e pasurisë në mënyrë të saktë dhe në kohë, si dhe të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar përsëritjen e mangësive të evidentuara.

## Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja C3 - Mangësi në klasifikimin e pasurive në regjistrin e pasurisë

#### Gjetja

Neni 5 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare ka përcaktuar klasifikimin e përgjithshëm të pasurive. Ndërsa neni 6.1 përcakton se “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël”.

Sa i përket klasifikimit të pasurive, kemi identifikuar çështjet si në vijim:

- Në bazë të rekomandimit nga viti i kaluar kemi vërejtur se Ministria ka filluar regjistrimin e tokave të shpronësuara në klasën përkatëse të pasurive “Toka”. Nga mostrat e testuara, në dy raste në vlerë prej 661,379€ kemi vërejtur se procesi nuk është zbatuar në përputhje të plotë me kërkesat kontabël, ngase, regjistrimi i pagesave për shpronësimet është bërë në mënyrë të grupuar, duke përfshirë disa pagesa të ndryshme në një regjistrim të vetëm, varësisht nga periudha apo lloji i pagesës. Përkatësisht, me një numër identifikues ish-in regjistruar disa parcela toke që nuk lidhen me të njëjtin projekt, gjë që krijon pasaktësi në pasqyrimin dhe menaxhimin e saktë të pasurive.

- Edhe pse ka filluar regjistrimi i tokave të shpronësuara në klasën e duhur (“Toka”), një pjesë e tyre, në vlerë prej 11,627,000€, ende mbetet e regjistruar gabimisht në klasën “Investime në vijim”. Kjo paraqet klasifikim të pasaktë të pasurive dhe ndikon në pasqyrimin e saktë të tyre në pasqyrat financiare.

- Projekti “Ndërtimi i autostradës Morinë - Merdarë” është regjistruar si pasuri në përdorim në klasën “Ndërtimi i autoudhëve”, bazuar në pagesat individuale të realizuara në vlerë totale prej 837,127,654€, me një zhvlerësim të akumuluar prej 571,197,839€. Megjithatë, nuk është bërë rekapitullimi i projektit në bazë të datës së pranimit teknik. Si rrjedhojë, për shkak të mungesës së informatave të sakta lidhur me kohën e funksionalizimit të kësaj pasurie, nuk ka qenë e mundur të kalkulohet saktë zhvlerësimi, si dhe të përcaktohet vlera e gabimit në PVF.

- Për projektin “Ndërtimi i gypësjellësit të ujit nga Shipoli (Brusë), Komuna e Mitrovicës - Tërnavce - Komuna e Skenderajit”, më datë 19.12.2025 është bërë kërkesa për transferimin e pagesave në vlerë prej 471,351€ nga

investimet në vijim në pasuri në përdorim. Megjithatë, kjo vlerë nuk përputhet me faturat e siguruara, të cilat në total arrijnë në 406,956€, duke rezultuar në një diferencë prej 64,394€.

Gjithashtu, data e regjistrimit (19.12.2025) nuk konsiderohet e saktë, pasi pasuria i përket viteve të mëhershme, çka tregon për gabim gjatë regjistrimit. Për më tepër, për shkak të mungesës së plotë të faturave, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet saktë diferenca, si dhe koha e përfundimit të kontratës, në mënyrë që të aplikohet saktë zhvlerësimi dhe të përcaktohet vlera neto e pasurisë.

- Për pagesën në vlerë prej 290,899€ për shërbimet e ekzaminimeve kontrolluese të materialeve dhe cilësisë së punimeve, Ministria e ka regjistruar këtë shpenzim si investim në vijim. Sipas konfirmimit të Ministrisë, kjo kontratë nuk ka qenë e lidhur me një projekt të vetëm, por ka përfshirë disa projekte infrastrukturore që kanë qenë në fazë ekzekutimi. Megjithatë, Ministria nuk ka bërë ndarjen e kostos sipas projekteve përkatëse dhe nuk ka ofruar evidencë për identifikimin e projekteve individuale. Si rrjedhojë, mungesa e ndërlidhjes me një projekt specifik pamundëson kapitalizimin e saktë të kësaj pagese dhe regjistrimin e saj si investim në vijim.

- Një pagesë në vlerë prej 14,813€ për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtatë laurave në dy parqe kombëtare është regjistruar si pasuri në përdorim në klasën "Parqet nacionale" më datë 22.10.2025, ndonëse projekti ende nuk ka përfunduar. Si rrjedhojë e regjistrimit si pasuri në përdorim në fund të vitit, nuk është aplikuar zhvlerësimi për këtë pasuri, ndërsa zhvlerësimi pritet të pasqyrohet në vitin vijues.

Mangësitë e identifikuar kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare, mungesës së kontroleve efektive në klasifikimin dhe regjistrimin e pasurive, si dhe mungesës së dokumentacionit të plotë mbështetës për disa projekte. Po ashtu, ka pasur mungesë të koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse dhe mosrishikim në kohë të regjistrave të pasurisë, çka ka ndikuar në regjistrime të pasakta dhe jo të plota.

#### **Ndikimi**

Klasifikimi i pasaktë i pasurive dhe regjistrimet jo të sakta ndikojnë në paraqitjen e pasaktë të pasurive në pasqyrat financiare, duke rritur rrezikun e mbivlerësimit apo nënvlerësimit të tyre. Gjithashtu, mungesa e informacionit të saktë për kohën e funksionalizimit të pasurive ndikon në llogaritjen jo të saktë të zhvlerësimit. Këto dobësi ndikojnë negativisht në menaxhimin e pasurisë dhe në besueshmërinë e raportimit financiar.

#### **Rekomandimi C3**

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të sigurojnë klasifikimin e saktë të pasurive në përputhje me kërkesat e rregullores dhe planit kontabël, duke bërë rishikimin dhe përditësimin e regjistrave të pasurisë. Po ashtu, duhet të sigurohet që çdo pasuri të regjistrohet veçmas dhe në bazë të dokumentacionit të plotë mbështetës, si dhe të bëhet lidhja e saktë e shpenzimeve me projektet përkatëse. Gjithashtu të sigurohet që regjistrimet të bëhen në kohën e duhur, bazuar në pranimin teknik të projekteve, në mënyrë që të mundësohet kalkulimi i saktë i zhvlerësimit dhe paraqitja e drejtë e pasurive në pasqyrat financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3.4 Të arkëtueshmet

MMPHI në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,267,729€. Këto kanë të bëjnë me obligime të pa-arkëtuara të kompanive shfrytëzuese të ujit, faturime për pompa të karburanteve, hyrje-daljet e objekteve afariste etj.

### Çështja B9 - Mos arkëtimi i të hyrave nga shfrytëzimi i tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale

#### Gjetja

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2014 mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale përcakton se "Tarifat për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale, shfrytëzimin e tokës e cila jepet me qira dhe vendosje të objekteve të përkohshme bëhet sipas tarifave të përcaktuara".

Më tutje, neni 6 (Dispozitat kalimtare) i këtij Udhëzimi Administrativ përcakton se "Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Ministria të modifikojë të gjitha kontratat për shfrytëzimin e tokës të cilat i takojnë rrugëve Nacionale dhe Rajonale brenda afatit prej gjashtë muaj.

Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me shfrytëzuesit e pronave publike, përcaktohen edhe afatet e inkasimit të të arkëtueshmeve.

Gjatë auditimit janë evidentuar dobësi në arkëtimin e të hyrave nga shfrytëzimi i tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale. Konkretisht:

Në tri raste, në vlerë totale prej 201,819€, kemi konstatuar se Ministria kishte faturuar kontraktuesit ndër vite, por nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e borxheve. Në këto raste, megjithëse janë aplikuar tarifat e reja, kontratat për shfrytëzimin e brezit rrugor, të lidhura që nga viti 2000, nuk janë modifikuar në përputhje me afatin ligjor të përcaktuar me UA.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve nga Ministria për ndjekjen dhe arkëtimin e të hyrave, përfshirë mos azhurnimin e kontratave dhe mos ndërmarrjen e masave ligjore ndaj borxhlinjve.

#### Ndikimi

Mosarkëtimi i borxheve ndikon në mosrealizimin e të hyrave të planifikuara dhe rrit rrezikun e humbjes së të hyrave nga shfrytëzimi i pronave publike.

#### Rekomandimi B9

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijoj mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A13 - Mosvazhdimi i lejeve ujore dhe mangësi në përlogaritjen dhe arkëtimin e obligimeve financiare****Gjetja**

Sipas Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147, çdo person fizik apo juridik që shfrytëzon burimet ujore apo kryen aktivitete që ndikojnë në regjimin ujor, është i obliguar të pajiset me leje ujore.

Tutje, neni 17, pika 2 e Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore përcakton se leja ujore e lëshuar mund të vazhdohet nga organi kompetent, sipas kërkesës së bartësit të lejes, e cila duhet të paraqitet së paku dy (2) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj. Gjithashtu, neni 10, pikat 3 dhe 4 të Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 06/2021 për Strukturën e Pagesave të Ujit përcaktojnë se “Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore mban regjistrin për përlogaritjen dhe mbledhjen e pagesave ujore”, ndërsa “Përlogaritja e pagesës ujore bëhet një (1) herë në vit në bazë të të dhënave të raportuara nga detyruesi”.

Nga testimi i dy mostrave të llogarive të arkëtueshme që rrjedhin nga shfrytëzimi i ujërave, kemi konstatuar se njëri operator është pajisur me leje ujore në vitin 2010 me afat vlefshmërie prej pesë viteve, ndërsa operatori tjetër në vitin 2012 me afat vlefshmërie prej dy viteve. Pas skadimit të lejeve përkatëse, operatorët kanë vazhduar ushtrimin e aktivitetit të shfrytëzimit të ujërave pa leje valide. Ministria ka vazhduar të lëshoj vendime financiare për këta operatorë deri në vitin 2022, duke u bazuar edhe në leje ujore të skaduara. Nga viti 2022, nuk janë lëshuar vendime financiare për këta operatorë me arsyetimin se nuk posedojnë leje ujore valide, ndonëse aktiviteti i tyre ka vazhduar.

Për më tepër, përkundër lëshimit të vendimeve financiare deri në vitin 2022, nuk kemi identifikuar dëshmi për pagesa të kryera nga këta operatorë, ndërsa nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk janë ofruar kartela financiare apo evidenca të tjera mbështetëse për verifikimin e gjendjes së obligimeve, përveç vendimeve financiare.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së një mekanizmi efektiv të monitorimit dhe kontrollit nga ana e organeve kompetente për menaxhimin e lejeve ujore.

**Ndikimi**

Kjo situatë ka ndikuar në mosarkëtimin e rregullt të të hyrave nga shfrytëzimi i ujërave dhe ka rritur rrezikun për humbje financiare për Ministrinë. Po ashtu, vazhdimi i aktivitetit pa leje valide dëmton zbatimin e legjislacionit dhe krijon trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve që i përmbushin obligimet dhe atyre që nuk i përmbushin.

**Rekomandimi A13**

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të siguroj që të gjithë operatorët që shfrytëzojnë burimet ujore të pajisen me leje ujore valide dhe të aplikojnë me kohë për vazhdimin e tyre. Gjithashtu, duhet të siguroj që të gjithë operatorët aktivë të bëhet përlogaritja dhe ngarkimi i rregullt i obligimeve financiare, si dhe të ndërmerren veprime për arkëtimin e tyre. Po ashtu, duhet të sigurohet mbajtja e evidencave të plota dhe të sakta për monitorimin e obligimeve dhe pagesave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar përmes Statutit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). Kjo njësi funksionon me gjithsej pesë auditorë (drejtori dhe katër auditorë). NjAB ka përgatitur planin vjetor të auditimit, në të cilin janë planifikuar nëntë auditime, prej tyre pesë të rregullta dhe katër me kërkesë. Deri në fund të vitit 2025 janë realizuar shtatë auditime (pesë të rregullta dhe dy me kërkesë). Nga auditimet e realizuara janë dhënë gjithsej 33 rekomandime, prej të cilave 16 janë zbatuar, 12 janë në proces zbatimi, ndërsa pesë nuk janë zbatuar.

#### Çështja B10 - Komiteti i Auditimit të Brendshëm jo funksional

##### Gjetja

Neni 4, pika 1 e Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2019 Për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit public përcakton se, "Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njesisë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit".

Që nga shfuqizimi i vendimit për themelimin e Komitetit të Auditimit në vitin 2022, Ministria nuk ka ndërmarrë veprime për ri-themelimin e tij. Kjo situatë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, duke rezultuar në mungesën e funksionimit të Komitetit të Auditimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve konkrete nga menaxhmenti për ri-themelimin e Komitetit të Auditimit dhe mospriorizimit të kësaj çështjeje në kuadër të kontrollit të brendshëm.

##### Ndikimi

Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit dobëson mbikëqyrjen e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kufizon mbështetjen ndaj auditimit të brendshëm, duke rritur rrezikun që dobësitë dhe parregullsitë të mos identifikohen dhe adresohen me kohë.

##### Rekomandimi B10

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndërmarrin veprime për ri-themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrje efektive e kontrollit të brendshëm dhe mbështetje e duhur për auditimin e brendshëm.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit janë identifikuar disa çështje të cilat i janë komunikuar menaxhmentit dhe janë adresuar në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Si rezultat, ato nuk kërkojnë veprime të mëtejshme dhe paraqiten vetëm për qëllime dokumentimi të komunikimit, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të arritura. Këto përfshijnë:

#### Çështja 1

#### Korrigjimi i Pasqyrave Vjetore Financiare

##### Gjetja

Në PVF për vitin 2025 janë evidentuar mangësi në prezantimin e disa zërave financiarë. Konkretisht, tek neni 14.6 nuk ishte shpalosur vlera prej 119,000€ në kolonën “Grantet e përcaktuara të donatorëve”. Po ashtu, në shënimin nr. 2 (paga dhe shtesa) dhe shënimin nr. 4 (komunali) nuk ishte prezantuar buxheti final në vlerë përkatësisht prej 5,521,190€ dhe 470,990€. Ndërsa, në nenin 16, të arkëtueshmet nuk ishin paraqitur sipas kodeve ekonomike të të hyrave, siç kërkohet me formatin e raportimit financiar.

##### Veprimi i kërkuar

Gjatë rishikimit të PVF-ve, auditori ka kërkuar nga Ministria që të korrigjojë pasqyrat vjetore financiare duke plotësuar dhe prezantuar në mënyrë të saktë të gjithë zërat financiarë, në përputhje me kërkesat e Rregullores MF Nr. 01/2017. Konkretisht, është kërkuar përfshirja e vlerës së munguar tek grantet e donatorëve, shpalosja e buxhetit final për kategoritë përkatëse, si dhe prezantimi i të arkëtueshmeve sipas kodeve ekonomike të të hyrave.

##### Rezultati

Ministria ka ndërmarrë veprime dhe ka korrigjuar zërat e identifikuar në PVF, duke i ridorëzuar ato në Thesar më 26.02.2026, me ç’rast janë adresuar mangësitë e evidentuara dhe është siguruar prezantim më i plotë dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

### 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>e</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>312,468,326</b>	<b>287,242,842</b>	<b>210,521,217</b>	<b>205,796,197</b>	<b>158,165,293</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	244,062,406	216,019,981	183,335,748	181,347,792	144,758,446
Financimi përmes huamarrjes	15,184,468	15,556,568	9,199,157	13,933,866	804,621
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	53,071,452	53,652,232	17,642,217	10,504,013	12,592,573
Të hyrat vetanake	150,000	150,000	0	0	0
Donacionet vendore	0	3	3	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,864,058	344,091	10,526	9,653

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 25,225,484€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i ndarjeve të reja dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2025 MMPHI kishte shpenzuar 210,521,217€ apo 73.3% të buxhetit final, pra me një ulje rreth 5% në raport me vitin paraprak. Në këtë përqindje të realizimit ka ndikuar në masë më të madhe mos-shpenzimi i fondeve të ndara nga Klauzola e investimeve ku nga ky burim i fondeve në vitin 2025 nga 53,652,232€ të planifikuara, ndërsa ishin shpenzuar vetëm 17,642,217€ apo rreth 33%. Pra, zbatimi i buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe shpenzimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>312,468,326</b>	<b>287,242,842</b>	<b>210,521,217</b>	<b>205,796,197</b>	<b>158,165,293</b>
Pagat dhe mëditjet	5,305,188	5,521,190	5,511,947	4,736,244	4,418,972
Mallrat dhe shërbimet	34,588,786	34,795,771	22,840,279	23,510,129	19,063,632
Komunalitë	481,490	470,990	284,465	194,850	244,868
Subvencionet dhe transferet	2,043,814	2,105,230	1,972,395	1,322,059	1,121,754
Investimet Kapitale	270,049,048	244,349,661	179,912,130	176,032,915	133,316,067

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte rritur për 216,002€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve buxhetore në vlerë prej 203,751€, ndonëse kishte edhe shkurtime buxhetore prej 1,068€, si dhe ndarje nga fondet e donatorëve në vlerë prej 13,319€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 5,511,947€ apo 100%.


- Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) ishte rritur për 196,485€. Ky ndryshim erdhi si rezultat i kombinimit të shkurtimeve dhe ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë, përfshirjes së donacioneve si dhe mjeteve nga huamarrja. Realizimi ishte 23,124,744€ apo 66%. Mosrealizimi lidhet kryesisht me vonesën në kryerjen e punëve dhe për projektet e financuara nga kreditë.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 61,416€ si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 1,972,395€ apo 94%.

- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 25,699,387€. Ky ndryshim ishte rezultat i shkurtimeve buxhetore në vlerë prej 38,795,849€ dhe ndarjes së mjeteve me vendime të Qeverisë në vlerë prej 13,096,462€. Shkalla e realizimit të buxhetit për investime kapitale ishte 179,912,130€ apo 74%.

Performanca u ndikua nga zgjatja e procedurave të prokurimit, ankesat në OSHP, bashkëfinancimet me komuna dhe vonesat në realizimin e projekteve përmes klauzolës së investimeve. Megjithëse projektet në bashkëfinancim shënuan realizim relativisht më të lartë, një numër projektesh nuk kanë filluar fare gjatë vitit, ndërsa pjesa më e madhe e projekteve në vazhdim kanë pasur realizim të pjesshëm. Në përgjithësi, kjo tregon për sfida në planifikim dhe zbatim të investimeve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MMPHI në vitin 2025 ishin në vlerë 4,256,910€. Të hyrat jo tatimore kryesisht kanë të bëjnë me të hyra të realizuara nga taksat e lejeve të vozitjes, taksat për lejet e ndërtimit, të hyrat nga shfrytëzimi i ujit, taksa për ushtrimin e veprimtarisë, licenca tjera për afarizëm etj, ndërsa të hyrat tjera kanë të bëjnë me të hyrat nga kthimi i mjeteve nga viti i kaluar.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>6,846,870</b>	<b>6,846,870</b>	<b>4,256,910</b>	<b>4,702,067</b>	<b>5,071,471</b>
Të hyrat jo tatimore	6,846,870	6,846,870	4,213,801	4,695,844	5,001,101
Të hyrat tjera	0	0	43,110	6,224	70,370

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Megjithatë, veprimet e ndërmarra për adresimin e rekomandimeve nuk ishin të mjaftueshme, ngase deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tri ishin zbatuar pjesërisht dhe për 10 rekomandime nuk ka filluar zbatimin ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndërmerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	Gjendja në raport me vitin paraprak lidhur me këtë kategori të të punësuarve ishte e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të shtojë kontrollet në regjistrimin e pasurive si dhe të siguroj se regjistri i pasurive është i plotë, pasuritë janë regjistruar drejtë dhe reflektojnë vlerën e saktë të tyre në regjistra. Tutje, të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre.	Edhe këtë vit janë identifikuar disa pasuri të paregjistruara si dhe regjistrime të gabuara të pasurive jo kapitale në SIMFK.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Edhe këtë vit shpалosja e detyrimeve kontingjente nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Edhe këtë vit janë identifikuar raste të keqklasifikimit të shpenzimeve në kategoritë Mallra dhe shërbime dhe Investime kapitale, duke treguar se nuk janë ndërmarrë veprime efektive për adresimin e rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës kontrole të duhura në respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht kushteve të pagesave të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktual.	Edhe këtë vit kishte tejkalim të vlerave të kontratave.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Baza për konkluzion	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme.	Gjatë këtij viti kemi hasur në dy raste të tejkalimit të sasive të kontraktuara pa aprovimin paraprak nga ZKA, që paraqet përmirësim krahasuar me vitin e kaluar, kur raste të tilla ishin më të shpeshta. Për rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.	Edhe këtë vit kemi hasur vonesa në realizimin e projekteve kapitale.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Investimet kapitale	Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.	Edhe këtë vit janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim

9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimimi
10.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se komisioni për inventarizimin e pasurive ka përgatitjen dhe njohuritë e duhura lidhur me pasuritë dhe procesin e inventarizimit, si dhe pas këtij procesi të gjitha ndryshimet të reflektohen në regjistrin e pasurive. Po ashtu, të sigurojë se kryhet vlerësimi i pasurive sipas kërkesave të udhëzuesit për menaxhimin e pasurive jo financiare.	Këtë vit, Ministria ka ndërmarrë veprime në drejtim të zbatimit të procesit të inventarizimit, ku komisionet e themeluara kanë kryer inventarizimin e pasurive, ndonëse jo në plotësi sipas kërkesave të rregullores. Si rrjedhojë, rekomandimi i vitit të kaluar konsiderohet pjesërisht i zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se të gjitha tokat e shpronësuara për të cilat ka përfunduar kompensimi i pronarëve dhe janë plotësuar kushtet e regjistrimit, të regjistrohen në klasën e pasurive 'Toka', ashtu siç parashihet me planin kontabël. Regjistrimi i pasurive duhet të bëhet në mënyrë individuale për çdo njësi të tokës së shpronësuar, ose mund të grupohet vetëm në rastet kur tokat lidhen drejtpërdrejt me realizimin e një projekti specifik, siç është ndërtimi i një rruge të caktuar. Paraprakisht mbajtja e trajnimeve përkatëse për zyrtarët e pasurive do të ndikonte në shtimin e kontrolleve për mbajtjen e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive jo financiare.	Këtë vit janë ndërmarrë veprime për regjistrimin e pagesave të shpronësimit në kategorinë e duhur të pasurisë. Megjithatë, procesi nuk është zbatuar në plotësi dhe janë identifikuar edhe çështje të reja lidhur me regjistrimin dhe mbajtjen e pasurive në klasa të pasakta. Si rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar

12.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.	Edhe gjatë vitit 2025, Ministria nuk kishte bërë ripërtëritjen e kontratave dhe nuk kishte arritur të bëjë inkasimin e borxheve.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.	Edhe këtë vit komiteti i auditimit nuk ishte funksional.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Lumni Mazreku, Anëtar i ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 15.06.2026 DATE: 15.06.2026 DATE: 15.06.2026			
Njësia Org. / Org. Unit	Shif. Klasif. / Klasiif. Kod / Class. Code	N. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Nr. foliove / Br. Stranica / No. Pages
03	47	1048	1



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT / MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION			
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr. Prot. / Prot. No.	Data: / Datum: / Date
04	6136		15.06.26
Nr. Faqeve / Br. Stranica / No. Pages			
01			
PRISHTINEJA			

**Republika e Kosovës**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
 Ministry of Infrastructure and Transport

15.06.2026

### LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025

Për: Zyra Kombëtare e Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj letre konfirmoj se:

- kam pranuar Draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit për vitin 2025;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në raport dhe nuk kam komente lidhur me përmbajtjen e tij;
- brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i Raportit Final, do të dorëzoj Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Dimal BASHA  
 Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
KATEGORIA E DOKUMENTIT		15-06-2026	
DATUMI PËR SHIKIMIN			
DATE E KËSHTJELSHME			
Pjesa/Org. / Org. Jedin./ Org. Unit	Shif. Klasif./ Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot./ Br. Prot. Prot. No.	Nr. ifaqeve/ Br. Stranica No. Pages
03	47	1036	1



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Niveli Org./ Org. Jedinica Org. Unit	7KF	No Prot/ Broj Prot. Prot. No.	3280/26
No. i faqeve/ Broj stranica No. pages	01	Data/ Datum Date	15.06.2026
PRISHTINE/IA			

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja

Ministry of Environment and Spatial Planning

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të MMPH, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohemme gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Fitore Pacolli Dalipi

Ministre- MMPH

Data: 15.06.2026



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Rikonstruktimi i rrugës Rajonale R123a,segmenti Prekoc-Marec-Krilevë me gjatësi L= 16,378.74 m, Rehabilitimi I rrugës Rajonale R105 Vushtrri - Skenderaj, Rehabilitimi I rruges N25.2 segmenti Kishnic Bresallc, Zgjerimi i rrugës Nacionale N 9, Prishtinë-Pejë, segmenti Dollc - Zahaq, Loti 3, Rehabilitimi i rrugës Rajonale R116, segmenti Doganaj-Gllloboçicë, Ndërtimi i rrugës rajonale R118,segmenti Mushtisht-Shtërpcë pjesa nga km (13+000 deri në km 18+059.60), me L=5,059.60m, Zgjerimin e rrugës Nacionale N25,segmenti QMI-Lipjan L=3820.0m
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.